

DEKLARATA E PSSP CAROLINE ZIADEH

NË KËSHILLIN E SIGURIMIT

Nju Jork

8 SHKURT 2024

Zonja presidente,

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Sigurimit,

Të respektuar përfaqësues,

Më lejoni të filloj duke ju falënderuar juve zonja presidente për këtë mundësi që na dhatë për t'i raportuar Këshillit lidhur me zhvillimet e fundit në Kosovë.

Para gati një viti janë arritur dy marrëveshje, gjegjësisht ajo e Brukselit më 27 shkurt dhe marrëveshja e Ohrit e datës 18 mars, përmes të cilave përcaktohet rruga drejt negociatave dhe angazhimi të ndërsjellë. Megjithatë, mosmarrëveshjet lidhur me renditjen e hapave zbatues kanë shkaktuar ngecjen. Zhvillimet pasuese, siç janë zgjedhjet në katër komuna të veriut të Kosovës që rezultuan me kryetarët të komunave të zgjedhur nga vetëm 3.47% të votuesve me të drejtë vote, trazirat përreth objekteve të atyre komunave më 29 maj që përfunduan me lëndime të shumta të civilëve dhe të 93 pjesëtarëve të KFOR-it, si dhe incidenti i rëndë në fshatin Banjskë më 24 shtator – që është ende nën hetime – dhe që qojë në fatalitete; kanë shënuar regres të madh.

Përkundër disa momenteve pozitive që u rishfaqen në fund të vitit të kaluar, me përparimin lidhur me targat e automjeteve, me “udhëzuesin për energji”, me dokumentet doganore dhe lidhur me pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në inicimin e referendumit për kërkimin e dorëheqjes së kryetarëve të komunave,

veprimet e njëanshme rreth çështjeve që qartazi hyjnë brenda procesit të dialogut politik dhe të marrëveshjeve të arritura në kuadër të tij janë arsye për shqetësime të mëdha. Pavarësisht se cila anë i ndërmerr ato veprime dhe cilat arsyetime jepen, dhe në mungesë të komunikimeve publike pa dykuptimësi, këto veprime krijojnë një mjedis të pasigurisë dhe mosbesimit.

Së fundmi, më 27 dhjetor 2023, Bordi i Bankës Qendrore të Kosovës ka miratuar një rregullore, me ç'rast deklaroi se duke filluar nga data 1 shkurt 2024, e vetmja valutë që lejohet për transaksione të parasë së gatshme në Kosovë do të jetë euro. Me këtë rast është dhënë një shpjegim i shkurtër për qytetarët, përkundër faktit se që nga viti 1999, dinari ka qenë si valutë primare *de facto* për transaksionet në para të gatshme dhe për ato komerciale në vendet e banuara me shumicë serbe në Kosovë. Me këtë rast preken dhjetëra mijëra individë, ashtu siç preket edhe ekonomia që varet nga fuqia blerëse e tyre.

Thënë më konkretisht, përmes kësaj rregulloreje ndërpritet pagesa e individëve të punësuar nga institucionet e financuara nga Serbia në Kosovë, e disa subvencioneve në bujqësi dhe e mirëqenies sociale, si dhe e pensioneve. Gjithashtu do të preken dukshëm edhe bizneset e vogla dhe të mesme, shërbimet shëndetësore dhe të arsimit, duke përfshirë edhe ato të kujdesit ndaj fëmijëve, pasi që edhe ato kanë pranuar fonde nga Serbia për një kohë të gjatë.

Duke marrë parasysh afatin e shkurtër të hyrjes në fuqi dhe qasjen e ardhshme të individëve të prekur në shërbimet bazike të ekonomisë dhe në ato sociale, ky vendim u bë çështje shqetësimi për komunitetet vendore dhe për palët ndërkombëtare.

Pas kësaj, dhe si reagim ndaj shqetësimeve të dukshme që janë ngritur, më 6 shkurt autoritetet e Kosovës shpallen një periudhë kalimtare njëmuajore për zbatim, që do të shoqërohet me fushatë të komunikimit. Përkundër kësaj, duket se jo të gjitha shqetësimet janë trajtuar lidhur me qarkullimin e dinarit, pasi që më

7 shkurt është ndaluar hyrja e një kamioni që bartte para, ndërsa policia e Kosovës më 3 shkurt konfiskoi katër milionë dinarë në komunën e Pejës, ku për këto raste ende priten veprime gjyqësore dhe administrative.

Zonja presidente,

Siç e kanë theksuar partnerë të shumtë ndërkombëtarë, këto çështje hyjnë në kuadër të Marrëveshjeve të Brukselit të viteve 2013 dhe 2015, përmes të cilave themelohet asociacioni/bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Dua të theksoj, zonja presidente, se veprimet pavarësisht ligjshmërisë dhe arsytimit së tyre, duhet të marrin parasysh ndikimin e tyre tek popullata e prekur. Përndryshe, këto veprime jo vetëm se rrisin tensionet, por edhe e dobësojnë potencialin për një paqe dhe siguri afatgjatë tek të gjitha komunitetet në Kosovë. Në frymën e parandalimit të konfliktit, duhet të bëhet më shumë për t'i fituar zemrat dhe mendjet e komuniteteve joshumicë.

Zonja presidente,

Më 26 janar dhe 2 shkurt, policia e Kosovës realizoi operacione në objekte të shfrytëzuara nga komuniteti joshumicë serb në komunat Dragash, Pejë, Klinë dhe Istog, si dhe në qendrën shëndetësore të komunitetit në Prishtinë. Policia e Kosovës deklaroi se në të gjitha katër lokacionet komunale janë konfiskuar dokumente të ndryshme, objektet janë plumbuar, ndërsa punonjësit janë dërguar në mbajtje për marrje në pyetje dhe më vonë janë liruar.

Po ashtu, gjatë një operacioni të mëhershëm të policisë në Pejë, më 2 janar, një ekip i gazetarëve të Radio Gorazhdevcit, medium i vetëm serb në atë region, raportoj se ishin ndalur dhe kontrolluar përkundër paraqitjes së kartelave të vlefshme identifikuese të gazetarëve. Siç jeni në dijeni, UNMIK-u dhe partnerët

tonë kryesorë i kushtojnë rëndësi shumë të madhe sigurimit të përhershëm të lirisë së mediave dhe të shprehjes.

As rregullorja e re e Bankës Qendrore të Kosovës e as operacionet e fundit të policisë së Kosovës nuk kanë kontribuar në deeskalimin e situatës, gjë që vazhdimisht kërkohet nga palët ndërkombëtare.

Në këtë aspekt, më duhet të nënvizoj rolin thelbësor parandalues që KFOR-i vazhdon ta ketë sot në terren.

Zonja presidente,

Në të gjitha deklaratat e mia, duke përfshirë atë të fundit më 6 shkurt, kam ritheksuar rëndësinë e sigurimit të sundimit të ligjit të lirë nga ndikimet politike dhe kam vënë në pah se të gjitha veprimet duhet të bazohen në parimet e të drejtave të njeriut. Së këndejmi, do të vazhdojë të kërkoj si nga Prishtina, ashtu edhe nga Beogradi që të angazhohen në mënyrë aktive dhe në mirëbesim në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja, si një vend për trajtimin e çështjeve më të ndjeshme të politikave, të cilat i prekin komunitetet.

Është thelbësore që përpjekjet drejt zgjedhjeve të negociuara dhe të pranuar nga të dyja palët të mos ngecin. Përpjekjet e vazhdueshme për ndërtimin e besimit dhe respektit më të madh të ndërsjellë janë e vetmja rrugë e mundshme drejt stabilitetit, prosperitetit dhe sigurisë. Historia vazhdimisht na ka mësuar se zgjidhjet e drejta nuk vinë nga veprimet e njëanshme, por nga përkushtimi i vazhdueshëm dhe i mundimshëm për hapjen e komunikimit dhe dialogut.

Rrjedhimisht, ne do të vazhdojmë me inkurajimin e të gjitha palëve me interes që të prioritetizojnë ndërtimin e besimit dhe atë jo vetëm në nivelet bazë, por në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe në mes të komuniteteve dhe institucioneve. Besimi zhvillohet vetëm në një atmosferë ku kultivohet respekti i ndërsjellë,

komunikimi i hapur, drejtësia, si dhe perceptimi dhe realiteti i trajtimit të barabartë.

Në përmbyllje, le të kujtojmë edhe njëherë se e vetmja rrugë e pranueshme përpara është ajo që bazohet në dialog dhe kompromis, që përqafon të drejtat e njeriut dhe siguron zbatimin e barabartë të sundimit të ligjit. Mund t'ju siguroj që UNMIK-u mbetet i përkushtuar në ofrimin e shërbimeve të mira drejt arritjes së këtij qëllimi përfundimtar.

Ju falënderoj.